



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 07.06.2016

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 9, DATË 17.02.2016 “PËR ZBATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE NGA AUTORITETET VENDORE TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 9, datë 17.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për zbatimin e planeve të përgjithshme vendore nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit”, bëhet ndryshimi si vijon:

a) Pika 1 zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

*“Në zonat sipas nenit 45, pika a), të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit të vijnë me hartimin e planeve të detajuara vendore, sipas kushteve zhvillimore dhe procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e miratimit të planeve të përgjithshme vendore, mbi të cilat bazohet dhe shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi.*

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**



**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**